



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 8/2023 (JR)

Nr. 8/2 regj.

Tiranë, më 14.5. 2025

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se, **ditën e martë, në datën 10.06.2025, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri nr. (JR) 8/2023, datë 24.02.2023, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 600, datë 19.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Robert Kote.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykses

Relatore e Çështjes

Gjyqtar

Gjyqtare

Gjyqtare

Albana Shtylla

Rezarta Schuetz

Sokol Çomo

Ina Rama

Mimoza Tasi

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në faqen e internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Me njoftim individual njoftohet subjekti i rivlerësimit, në të dhënat e kontaktit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në të dhënat elektronike të tij.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES

GJYQTARE

ALBANA SHTYLLA

